

POLITIKAT NË FOKUS: TREGTIA



Rreth publikimit 'Politikat në Fokus'

Në vitin 2016, Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë, fillon publikimin e dokumentit 'Politikat në Fokus' – i cili ka për synim të sjellë vëmendjen në politika të ndryshme ekonomike. Më tutje, ky dokument gjithashtu ka për qëllim të përmbledhë sfidat për zhvillimin e politikave të tilla në mënyrë që të hapet rruga drejt adresimit të tyre. Ky dokument do të publikohet në baza dy-mujore. Përderisa ky edicion i parë vë fokusin në Politikën Tregtare të Kosovës, edicionet e ardhshme do të jenë mbi politika të tjera me interes për sektorin privat.

Meqenëse ky është edicioni i parë i këtij publikimi, i njëjti mund të mos jetë gjithëpërfshirës sa duhet, mirëpo gjithsesi ne mbesim të përkushtuar që me komentet apo sugjerimet tuaja të vazhdojmë të përmirësojmë edicionet e radhës.

Politika e parë në fokus – tregtia

Ky dokument paraqet një përmbledhje të përgjithshme të bilancit tregtar të Kosovës, si dhe ka për qëllim të ofrojë disa alternativa për politika të cilat mund të ndiqen nga institucionet shtetërore në forcimin e politikës tonë tregtare. Në tërësi, ky dokument e vendos fokusin në trendet e tregtisë së jashtme në Kosovë, çështjet kryesore lidhur

me politikën tregtare në vend – përfshirë edhe instrumentet e kësaj politike, dhe sektorët strategjik të identifikuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë.

Pasqyrë e Bilancit Tregtar të Kosovës

Kosova ka vazhduar të tregojë performancë pozitive ekonomike në dekadën e fundit. Edhe pse ndikimi i krizës ekonomike që e ka goditur Eurozonën nuk është ndier në tërësi në vend, rritja reale vjetore e BPB ka ndryshuar në mes të 4.5% në 2008 në 1.2% në 2014. Ky nivel i rritjes nuk është ende në nivelin e duhur për të ofruar zhvillimin ekonomik për të cilin Kosova ka nevojë. Në mes të sfidave kryesore me të cilat përballet vendi vazhdon të jetë deficit i lartë tregtar dhe varësia në importe.

Ky seksion ofron një pasqyrë të përgjithshme të bilancit tregtar të Kosovës, me theks në strukturën e produkteve që tregtohen dhe partnerët tregtar kryesor.

Në fokus:

- Bilanci tregtar i Kosovës
- Instrument et kryesore politike
- Sfidat kryesore për Kosovën
- Sektorët strategjik




Figura 1: Bilanci Tregtar i Kosoves 2005-2014

Bilanci i përgjithshëm tregtar

Importi përbën pjesën më të madhe të shkëmbimit tregtar të Kosovës. Me rritjen e ekonomisë, si importet ashtu edhe eksportet kanë shënuar nivelet më të larta në 2014. Ndërsa, deficitin më të lartë tregtar është shënuar në 2012, kur krahasuar me importet, eksportet ishin më të ulëta.

Struktura e produkteve

Struktura e produkteve që Kosova i ka eksportuar dhe importuar nga viti 2005 deri në vitin 2014, ka përcjellë trende relativisht të njëjta në aspekt të tipit të produkteve që tregtohen përtej kufijve.

Për sa i përket eksporteve, tri produktet kryesore që janë eksportuar më së shumti përfshijnë metalet bazë, minerale, dhe makineritë, si është paraqitur në tabelën 1.

Megjithatë, në total, eksportet vazhdojnë të mbesin shumë të ultë në krahasim me importet. Për sa i përket importeve, produktet minerale mbajnë vendin e parë, përcjellë nga produktet ushqimore (përfshirë këtu duhanin dhe pijet), si dhe makineritë.

Fakti që importet ende mbesin shumë më të mëdha se eksportet, si në përbërje ashtu dhe diversitet, e ngrit nevojën për hartimin dhe implementimin e politikave tregtare më dinamike.

Nr.	Eksporti		Importi	
	Produktet	Eksporti në total 2005-2014	Produktet	Importi në total 2005-2014
1	Metalet bazë dhe produktet e tyre	€ 1,201,552	Produktet minerale	€ 3,906,017
2	Produktet minerale	€ 301,997	Produktet ushqimore (përfshirë pijet dhe duhanin)	€ 2,622,393
3	Makineria (pajisje mekanike dhe elektrike)	€ 120,303	Makineria (pajisje mekanike dhe elektrike)	€ 2,388,273

Tabela 1: Eksporti dhe importi ne total 2005-2014

- Patatet;
- Verëra;
- Produktet e qumështit;
- Mollat, etc.

Partnerët kryesor tregtar

Tregu i përbashkët i BE-së mbetet partneri kryesor tregtar i Kosovës. Në 2014, 30% të esporteve janë plasuar në tregun e BE-së, ndërsa shumica e pjesës së mbetur i përkasin tregut të CEFTAs. Interesant është fakti se Kina dhe India janë në radhë si partnerë kryesor të eksportit për këtë vit, si rezultat i sasisë së madhe të mineraleve që eksportohet.

43% e importeve të Kosovës vijnë nga Bashkimi Evropian. Përderisa, krahasuar me eksportin, importi nga shtetet e CEFTAs është rreth 10% më i ulët, edhe pse në vlerë totale mbetet shumë më i lartë. Turqia dhe Kina, përcjellë nga shtetet e EFTAs paraqesin partnerët kryesor të importit për vitin 2014.

Marrëveshjet e Tregtisë së Lirë

CEFTA

Kosova është anëtarësuar në Marrëveshjen e Evropës Qendrore për Tregti të Lirë (CEFTA) në vitin 2007, me qëllim që të hapë rrugën drejt anëtarësimit në OBT. Momentalisht, Kosova përfiton nga një regjim i tregtisë së lirë me Shqipërinë, Maqedoninë, Serbinë, Moldavinë, Malin e Zi, dhe Bosninë e Hercegovinën ku edhe i ekspozohet një tregu prej 20 milionë konsumatorëve. Përmes kësaj marrëveshjeje, bizneset e Kosovës përfitojnë nga një qasje më e lehtë në tregje, konsumatorët përballen me një larmi të produkteve, dhe komuniteti në përgjithësi e ka përdorur atë si vegël për shkëmbim të njohurive, informatave, dhe praktikave mes palëve të CEFTA-s.

GSP me ShBA

Nga dhjetori 2008, Kosova gëzon trajtim preferencial nën Sistemin e Përgjithshëm të Preferencave të Shteteve të Bashkuara – një program që mundëson plasimin e produkteve kosovare në tregun e ShBA-ve pa detyrime doganore. Tani për tani, rreth

3500 produkte kosovare janë pjesë e GSP, përfshirë këtu produkte të përpunuara, lëndë të para, produkte të bujqësisë dhe peshkatarisë, kemikale, minerale, mermer, etj.

Në 2012 produkte në vlerë të vetëm 29000 dollarëve janë eksportuar nga Kosova në ShBA nën GSP, shumica e të cilave janë salcë. Megjithatë, në vitet pasuese, veçanërisht në vitin 2014 dhe 2015, ka pasur një rritje të eksporteve në përgjithësi, ashtu si është paraqitur në tabelën 2.

	2014	2015
Totali i eksportit të Kosovës në ShBA (rieksporti i përfshirë)	749,657.85	1,765,787.73

Tabela 2: Eksportet kosovare ne ShBA

Marrëveshja për Stabilizim Asociim me BE

Marrëveshja për Stabilizim Asociim (MSA) e nënshkruar më 27 tetor, 2015, mes Republikës së Kosovës në njërën anë, dhe Bashkimit Evropian në anën tjetër, përbëhet nga 10 kapituj që mbulojnë aspektet politike dhe ekonomike të procesit integruar. Në janar 2016, Parlamenti i Evropian ka ratifikuar marrëveshjen dhe kjo e fundit pritet të hyjë në fuqi në tremujorin e parë të vitit 2016.

Në aspekt të tregtisë, Kosova është përkushtuar të vazhdojë lehtësimin e lëvizjes së lirë të mallrave dhe shërbimeve, bazuar në koncesionet e përbashkëta të ndërrmarra nga palët, si dhe duke qenë në përputhshmëri të plotë me Marrëveshjen e Përgjithshme për Tregti dhe Tarifa (GATT 1994) dhe Marrëveshjen e Përgjithshme për Tregtinë me Shërbime (GATS). Sipas kapitullit IV të kësaj marrëveshjeje, Kosova do të ndërtojë gradualisht një zonë të tregtisë së lirë brenda një periudhe prej 10 vitesh.

Megjithatë, 14 produkte kosovare nuk janë negociuar dhe të njëjtat do të vazhdojnë të mbajnë tarifë doganore prej 10% përgjatë periudhës sa kjo marrëveshje është në fuqi.

Një aspekt shumë i rëndësishëm i MSA-së do të jetë edhe inkurajimi i bizneseve që eksportojnë në BE të ngrisin kualitetin e produkteve dhe të zbatojnë standardet e BE-së.

MTL me Turqinë

Në vitin 2013, Qeveria e Kosovës ka nënshkruar një Marrëveshje të Tregtisë së Lirë me Republikën e Turqisë. Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë ka dërguar rekomandimet e kompanive të veta anëtare mbi listën e produkteve që do të përfshiheshin brenda kësaj MTL. Marrëveshja ende nuk është ratifikuar.

Instrumentet e Politikës Tregtare

Tarifat

Ekziston një konsensus i përgjithshëm se vendosja e tarifave të importit është zvogëluar përgjatë viteve pas Depresionit të Madh në ShBA. Në këtë aspekt, mesatarja e tarifave doganore ka shënuar nivele shumë të ulëta për disa nga ekonomitë më të mëdha. Në drejtim të rrugës së saj të integritit në BE dhe anëtarësimit në OBT, edhe Kosova i ka përcjellur trendet ndërkombëtare të politikave tregtare, duke i mbajtur detyrimet doganore në nivele të ulëta. Tani për tani, në Kosovë ekziston një tarifë 10% në importe dhe akcizë në importe që varion nga 10 në 50% të vlerës së produktit. Disa produkte, në veçanti lëndët e para që përdoren në prodhim, nuk i nënshtrohen detyrimeve doganore me

qëllim të stimulimit të prodhimit vendor.

Megjithatë, anëtarësimi i Kosovës në CEFTA, marrëveshjet e tregtisë së lirë, dhe MSA-ja e nënshkruar së vonmi, e obligojnë vendin që të mbajë tarifa zero për shumicën e produkteve. Duke pasur në konsideratë se pjesa më e madhe e konsumit të vendit varet nga importet dhe kostot e produkteve finale të cilat aociohen me tarifën e importit, është më e preferueshme që politikën e vendit të drejtohen drejt krijimit të një ambienti më të favorshëm afarist që mundëson konkurrencën dhe zhvillimin e sektorit privat, duke shmangur nevojën për përdorimin e instrumenteve klasike të politikës tregtare, siç janë tarifën. Në këtë aspekt, një çështje tjetër që duhet marrur parasysh është që ekonomia e Kosovës është lojtar relativisht i vogël në tregun ndërkombëtar dhe si i tillë nuk e ka fuqinë e nevojshme ekonomike në mënyrë që të vendosë tarifa pa i'u kanosur rrezikut të masave reciproke.

Zëvendësimi i Importit

Si një koncept që ka për qëllim të fuqizojë insdutrinë vendore duke i limituar importet, zëvendësimi i importit ishte një ndër instrumentet tregtare më të përdorura deri në vitet 1980. Më saktësisht, kjo politikë kërkon mbështetje të industrive të reja nën arsyetimin se pas një periudhe kohore të njëjtat do të jenë në gjendje të konkurrojnë ndërkombëtarisht. **Praktika ka treguar se shtetet të cilat kanë ndjekur politika të tilla janë zhvilluar në mënyrë të kondiserueshme më pak, në krahasim me të tjerat.**

Pikëpamjet janë të ndara kur konsiderohet se a duhet Kosova të ndjekë një politikë të tillë tregtare. Parimet e ekonomisë së hapur të tregut, përfshirë këtu hapjen drejt tregtisë ndërkombëtare janë të rrënjësura në Kushtetutën e Kosovës.

Tatimi i Vlerës së Shtuar :	<i>8% për produkte bazike</i>
	<i>18% për produktet tjera</i>
Detyrime Doganore:	<i>10%</i>
Akciza:	<i>Ndryshon në bazë të produktit</i>

Duke marrë parasysh synimet e vendit për njohje ndërkombëtare, trendë të tillë janë ndjekur nga Qeveria e Kosovës në të kaluarën. Në njërën anë, vështirësitë për qasjen në financa, informaliteti, dhe dështimet e tregut lënë të kuptohet se ekziston arsye që institucionet qeveritare të implementojnë politika për zëvendësimin e importit në vend. Mirëpo, një mënyrë më e qëndrueshme për përmirësimin e bilancit tregtar do të ishte përmes përmirësimit të ambientit afarist, i cili rrjedhimisht do të krijonte kushtet për zhvillim të kompanive private.

Mbështetja e industrive vendore që ato të fitojnë përparësinë e tyre konkurruese, ka qenë një kërkesë e vazhdueshme e disa sektorëve privat në Kosovë. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë, dhe Zhvillimit Rural ka qenë një nga institucionet që ka mbështetur me grante disa sektorë bujqësor dhe të përpunimit të ushqimit në vend, me qëllim të përmirësimit të kapaciteteve të tyre për mbulim të tregut vendor. Maqedonia dhe Serbia janë dy nga vendet rajonale të cilat kanë implementuar subvencionimin e drejtpërdrejtë dhe grantet për komunitetin e biznesit.

Për sa i përket formave të tjera të zëvendësimit të importit, me nënshkrimin e MSA-së, Kosova ka përcaktuar koncesionet e saja lidhur me produktet të cilat vendi ka potencial t'i prodhojë. Në këtë aspekt, rreth 14 produkte kosovare do t'i nënshtrohen tarifave doganore nën MSA. Masa të tjera mbrojtëse në import nuk ekzistojnë momentalisht, mirëpo disa raste të aplikimit të tyre janë shënuar për periudha të shkurta në të kaluarën.

Në tërësi, Qeveria duhet të jetë shumë e kujdesshme nëse ndjek politika të tilla, pasi që gjithmonë ekziston rreziku i inkurajimit të ineficiencës në industri të reja, dhe heqja dorë nga përparësitë që vendi mund t'i ketë si rezultat i liberalizimit të tregtisë, dhe çregullimin e tregut të brendshëm

Promovimi i Eksportit

Politika Tregtare e Kosoës është kryesisht e bazuar në parimet e tregtisë së lirë, me fokus të veçantë në promovimin e eksportit. Përderisa benefitet e kësaj politike janë të drejtuara kah përmirësimi i konkurrueshmërisë vendore për qasje në tregje ndërkombëtare, hapat konkret të ndërmarrë nga qeveria në këtë aspekt kërkojnë vëmendje më të madhe.

Në Politikën Tregtare të Kosovës, e publikuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, shumica e hapave që parashihet të ndërmirren janë të orientuara në përmirësimin e performancës në eksport. Për shembull, sa i përket produkteve bujqësore, në këtë dokument specifikohet se duhet të ndërmirren hapat në vijim:

- Program për subvencionim
- Përmirësimi i produktivitetit
- Promovimi i qasjes dhe depërtimit në tregje
- Përputhja me standarde ndërkombëtare

Përderisa një program i subvencionimit zbatohet nga Ministria e Bujqësisë, ai nuk është drejtuar në përmirësimin e produktivitetit dhe kualitetit, mirëpo nuk janë ndërmarrë politika specifike për promovim të eksportit.

Përpos potencialit që vendi e ka në bujqësi, fakti që kjo industri vazhdon të karakterizohet nga një volum shumë i madh i importeve është indikator se shumë më shumë duhet bërë për përmirësimin e cilësisë dhe standardizimit.

Në aspekt të produkteve industriale, politika tregtare e Kosovës gjithashtu synon promovim të eksportit. Hapat specifik të listuar më poshtë janë cekur në këtë politikë:

- Përmirësimi i sigurisë së prodhimit
- Inkurajimin e infrastrukturës ndër-kufitare
- Promovimin e kualifikimit personal
- Përmirësimin e teknologjisë

Me ndërtimin e autostradës për Shqipëri, transporti i mallrave është lehtësuar në masë të madhe, kështu duke përmirësuar shkëmbimin tregtar përmes porteve detare të Shqipërisë. Kjo së bashku me lidhjen që Kosova ka me portet e tjera detare në rajon (të listuara më poshtë) ofrojnë infrastrukturë shumë të mirë për transport:

- Porti i Durrësit (Shqipëri): 263 KM /163 Milje – Marrëveshje për transit me Shqipërinë
- Porti Selanikut(Greqia): 331 KM /205 Milje
- Porti i Tivarit(Mali i Zi): 303 KM /188 Milje

Krijimi i grupimeve industriale për lehtësimin e infrastrukturës mes bizneseve të sektorëve të ngjashme për eksport, është pjesë e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim të Kosovës. Në këtë aspekt, momentalisht ekzistojnë **dy parqe të biznesit** – në Drenas dhe Mitrovicë, **një park industrial** – në Mitrovicë, **një park të teknologjisë** – në Shtime, **një zonë agro-industriale** – në Sukarekë, dhe **tri zona të lira ekonomike** – në Mitrovicë, Gjakovë, dhe Prizren.

Përderisa parqet e biznesit janë treguar të suksesshme deri në një pikë, ku një numër i bizneseve vetëm se janë vendosur në ato parcela dhe kanë krijuar qasje në infrastrukturë, të njëjtave ende u mungojnë shërbime shtesë të cilat do të përmirësonin konkurrueshmërinë dhe lehtësonin eksportin. Ngjashëm, edhe pse tri qytete janë shpallur zona të lira ekonomike tash e një kohë këto plane nuk janë jetësuar ende. Infrastruktura fizike dhe institucionale për transformim të këtyre qyteteve në zona të lira ekonomike, që kanë kontroll mbi mallrat që hyjnë dhe dalin nga territori i tyre, mbetet të krijohet në të ardhmen.

Në mënyrë që të përmirësohet konkurrueshmëria e kompanive kosovare në tregun ndërkombëtar, **Qeveria duhet të funksionalizojë zonat e lira ekonomike**, për shembull duke mundësuar përpunimin e produkteve pa i'u nënshtuar detyrimeve tatimore brenda zonave, duke mundësuar shfrytëzimin e infrastrukturës së përbashkët, dhe përmirësuar shkëmbim të njohurive mes kompanive.

Një çështje shqetësuese për sektorin privat në përgjithësi, e cila ndikon në konkurrueshmërinë e bizneseve kosovare në tregun ndërkombëtar, është shkathtësia e fuqisë punëtore. Shteti duhet të angazhohet në promovimin e kualifikimeve profesionale si një mënyrë për uljen e boshllëkut të shkathtësive, së bashku me ndjekjen e politikave që përmirësojnë qasjen në teknologji.

Në përgjithësi, për sa i përket promovimit të eksporteve, përmes politikës tregtare qeveria ka synuar të krijojë mundësi të barabarta për eksportuesit kosovar karshi kompanive ndërkombëtare, të identifikojë tregjet në zhvillim për produkte kosovare, si dhe të ofrojë një kornizë institucionale që siguron diversifikimin e eksporteve.

Procedurat me Ndikim Ekonomik

Procedurat me Ndikim Ekonomik (PMNE) synojnë që të krijojnë inventiva për të bërit biznes në Kosovë. Në këtë aspekt, Dogana e Kosovës ofron disa mundësi për kompanitë në sektorin e tregtisë dhe prodhimit, në mënyrë që të lehtësojë shkëmbimin ndërkufitar të produkteve dhe përmirësojë bilancin tregtar të vendit.

Tani për tani, Dogana e Kosovës ofron PMNE-të në vijim, dhe informata të detajzuara mbi secilën prej tyre mund të gjendet në uebfaqen e këtij institucioni:

1. Depo Doganore
2. Procedura e Përpunimit të Brendshëm
3. Procedura e Përpunimit të Jashtëm
4. Procedura e Importit të Përkohshëm
5. Procedura e Përpunimi nën Kontroll Doganor

Këto procedura ofrojnë një gamë të gjerë të lehtësirave për kompanitë që i përdorin ato, veçanërisht në aspekt të eksportit. Për shembull, Procedura e Përpunimit të Brendshëm ofron lirim nga detyrimet doganore për produkte të importuara nga jashtë Kosovës që përpunohen dhe ri-eksportohen/ eksportohen nga Kosova. Procedura e Importit të Përkohshëm ofron suspendim të detyrimeve për produkte të importuara që do të eksportohen/ ri-eksportohen.

Në mënyrë që këto procedura të prodhojnë efektet e tyre të duhura, Dogana e Kosovës duhet të punojë më tutje drejt promovimit të tyre dhe lehtësimit të kushteve për kompanitë që i përdorin ato.

Masat Antidamping, Kundërbalancuese dhe ato Mbrojtëse

Ligji për Masat Antidamping dhe Masat Kundërbalancuese, dhe Ligji për Masat Mbrojtëse në Import, paraqesin instrumente

të politikës tregtare që mundësojnë mbrojtjen e tregut, pavarësisht marrëveshjeve të tregtisë së lirë që janë në fuqi dhe shërbejnë si pengesë për vendosjen e masave mbrojtëse. Mirëpo, këto instrumente duhet të përdoren me kujdes në mënyrë që të shmangët çregullimi i tregut vendor dhe rreziku i reciprocitetit, meqenëse janë konsumatorët final ata të cilët ballafaqohen me çmime më të larta në treg.

Për sa i përket masave mbrojtëse, mbështetës të tregtisë së lirë argumentojnë se masat antidamping, ato kundërbalancuese, dhe ato mbrojtëse duhet të jenë alternativa e fundit për qeveritë, dhe se metoda të tjera të dialogut dhe bashkëpunimit duhet të shfrytëzohen fillimisht. Për shembull, në rastin e CEFTA-s, Kosova ka ngritur çështje të ndryshme (p.sh. barriera jotarifore) në Sekretariatit e CEFTA-s, ku edhe shumica janë zgjedhur me dialog pa pasur nevojë për të shfrytëzuar masat e reciprocitetit. Ngjashëm, në raste kur Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka pasur indikacione se produkte të ndryshme janë duke u dampuar në tregun e Kosovës, ajo fillimisht ka kontaktuar me kompanitë dhe u ka kërkuar atyre që të reflektojnë në çmime, para se të vendosë gjopa direkte.

Sfidat për Kosovën

Përkundër punës që është bërë deri tani në Kosovë për promovimin e liberlizimit të tregtisë dhe implementimin e parimeve të tregtisë së lirë, vendi ende ballafaqohet me sfida të shumta që cenojnë zhvillimin e mirëfilltë të tregtisë ndërkombëtare. Disa nga sfidat kryesore në tregtinë e lirë që janë hasur në Kosovë janë sqaruar më poshtë.

Barrierat jotarifore të hasura nga kompanitë eksportuese

veçanërisht me vendet anëtare të marrëveshjes CEFTA është një problem që vazhdon të paraqitet që kur Kosova është bërë pjesë e marrëveshjes. Disa nga barrierat më të shpeshta jotarifore që paraqiten janë:

- Pamundësia e përdorimit të territorit të Serbisë si tranzit për produkte të caktuara me destinim vende tjera;
- Kërkesat e tepërta teknike për eksportimin e produkteve të caktuara në Shqipëri;
- Kërkesat e tepërta për dokumentacion;
- Verifikime të shumta të produkteve nga agjenci të ndryshme etj.

Profilizimi bazuar në vlerësim të riskut - Për momentin Dogana e Kosovës bën profilizimin e riskut për importime bazuar në disa kritere siç janë vendi i origjinës, lloji i mallrave të importuara etj., pa marrë në konsideratë historikun e një kompanie specifike në aspekt të deklaratave dhe pagesave të detyrimeve doganore. Në këtë aspekt, Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë ka propozuar që ky profilizim të bëhet në bazë të vlerësimit të riskut në nivel të ndërmarrjes, duke pasur në konsideratë historikun që secila kompani ka në aspekt të rregullsisë së pagesës së detyrimeve ndaj shtetit.

Rivlerësimet e mallrave dhe kostos së transportit

– është gjithashtu një çështje që përsëritet kohë pas kohe bazuar në kontaktet me sektorin privat. Në këtë aspekt, Dogana në raste të caktuara shqyrton faturat e prezantuara duke u bazuar në çmime referenciale, dhe në shumë raste çmimet e paraqitura nga kompanitë ndryshojnë nga çmimet referenciale, qoftë për shkak të marrëveshjeve të veçanta mes partnerëve afaristë, zbritjeve të ndryshme, apo thjesht për shkak se çmimi i produkteve ka shënuar rënie. Një praktikë e ngjashme ndiqet edhe me fatura të transportit, të cilat shumëherë

janë rivlerësuar bazuar në çmime referenciale.

Mosnjohja e humbjeve të produkteve

veçanërisht për produkte që humbin gjatë transportit, përmes avullimit apo humbjes në peshë, ka ngritur në masë të konsiderueshme koston për industri të caktuara. Për shembull, industria e naftës dhe prodhuesit e verës zakonisht ballafaqohen me avullimin e produkteve gjatë transportit apo edhe ruajtjes në deponi. Duke pasur parasysh se për momentin nuk ka asnjë ligj që rregullon këtë çështje, autoritetet doganore dhe tatimore i obligojnë kompanitë që të deklarojnë këto produkte dhe për të njëjtat të paguhen detyrimet e ndryshme, pa marrë parasysh se ato produkte nuk pranohen asnjëherë nga kompanitë. Oda Amerikane ka propozuar të fillohet draftimi i një ligji të veçantë që do të rregullonte këtë fushë në mënyrë gjithëpërfshirëse.

Kërkesa për të mbuluar borxhin doganor në vlerë prej 100%

– kompanitë në Kosovë duhet të ofrojnë garancion financiar në vlerë prej 100% (nga bankat apo kompanitë e sigurimit) në rast se të njëjtat për ndonjë arsye nuk paguajnë detyrimet e suspenduara doganore dhe tatimore (p.sh. në rastet kur kompanitë përdorin procedurat me ndikim ekonomik). Kjo është një sfidë e madhe për sektorin privat që drejtpërdrejt ndikon në kapitalin punues të kompanive dhe u shkakton atyre vështirësi në aspekt të parave të gatshme, duke iu limituar kështu mundësinë e zhvillimit më të shpejtë. Rekomandohet që për këtë çështje të amandamentohet Kodi Doganor që të mundësohet që garancionet financiare të kërkohen duke u bazuar në vlerësim të riskut për evazion të mundshëm (p.sh. të mundësohet që të kërkohet vlerë më e vogël e garancionit- 25% apo 50%).

Bordi i Pavarur për Rishqyrtimin e Ankesave— për një kohë të gjatë ky bord ka shërbyer si shkallë e dytë e ankesës për kontestet doganore dhe tatimore. Duke pasur parasysh se bordi ka qenë i përbërë nga ekspertë të fushës, një gjë e tillë ka mundësuar një rishikim më profesional të fakteve të rastit. Megjithatë, me shuarjen e këtij bordi, tani procedurat e zgjidhjes së kontesteve marrin më shumë kohë dhe janë më të vështira për bizneset. Këshilli Konsultativ Ministri e Financave-ATK-Dogane- Komunitet i Biznesit ka marrë iniciativë për rithemelimin e këtij bordi.

Informaliteti – në masë të madhe limiton krijimin e një fushe të barabartë të konkurrencës për të gjitha kompanitë, paraqet një dritare për cenimin e drejtave pronësore dhe intelektuale, dhe i dekurajon investimet e huaja potenciale. Përderisa duhet të theksohet progresi i deritanishëm në këtë fushë nga Dogana, duhet të thuhet se ende mbetet shumë punë për t'u bërë që të ndalohet kontrabanda dhe rrjedhimisht të kontrollohet më mirë tregu.

Koordinimi ndërinstytucional— në disa sektorë mbetet shumë sfidues koordinimi mes zyrtarëve të institucioneve të ndryshme për të zgjidhur sfidat me të cilat ballafaqohen bizneset, apo thjeshtë për të kryer detyrat e tyre në mënyrë më efikase. Për shembull, në sektorin farmaceutik, kontrolli kufitar i produkteve medicinale kryhet nga inspektorati farmaceutik në baza javore. Si rezultat, kompanitë që importojnë produkte të tilla duhet të presin në pikëkalime kufitare me ditë të tëra për shkak se nuk ka data specifike kur këto vizita do të kryhen.

Sektorët strategjik në Kosovë

Mes sektorëve strategjik që paraqesin potencial për rritje të eksportit janë përpunimi i ushqimit dhe produkteve bujqësore, ndërtimtaria, dhe industria e përpunimit të

drurit. Këta sektorë të identifikuar në publikime të ndryshme janë identifikuar duke u bazuar në burimet që Kosova ka dhe duke u bazuar në industritë që kanë pasur një performancë më premtuese të eksportit gjatë viteve të kaluara. Paragrafët në vijim paraqesin një pasqyrë më të detajuar të këtyre industrive. Eksporti i shërbimeve nuk do të elaborohet në këtë punim, meqenëse do të trajtohet më detajisht në ndonjë nga edicionet e ardhshme të këtij publikimi.

Bujqësia dhe përpunimi i ushqimit

Ky sektor luan rol të rëndësishëm në ekonominë kosovare, duke pasur parasysh që më shumë se 50% e popullatës jeton në zona rurale. Sipas një studimit të publikuar nga UNDP, pjesëmarrja e këtij sektori në Bruto Produktin Vendor është rreth 15%, si dhe ka potencialin më të lartë për punësim. Përkundër faktit që deficiti tregtar gjatë viteve të fundit është rritur në sektorin bujqësor, duhet të potencohet që edhe eksportet kanë shënuar rritje.

Për momentin 80% e eksporteve të Kosovës në këtë sektor janë për vendet anëtare të CEFTA, përderisa vetëm 40% e importeve vijnë nga këto shtete. Shqipëria është vendi i vetëm me të cilin Kosova kë balanc pozitiv tregtar sa i përket produkteve bujqësore, pra ku eksportet janë më të mëdha se importet. Bilanci më negativ tregtar në këtë sektor është me Serbinë dhe Maqedoninë. Për shkak konkurrueshmërisë së vogël, Kosova nuk ka arritur të shfrytëzojë plotësisht përfitimet që dalin nga tregtia e lirë në sektorin bujqësor, dhe vërehet që sektori ka nevojë për politika që do të rrisnin konkurrueshmërinë e industrisë me shtetet fqinje.

Produktet e ndërtimit

Duke pasur parasysh projektet e ndryshme infrastrukturore, ky sektor ka kaluar një periudhë të rritjes së shpejtë viteve ë fundit. për momentin, rreth 40% të produkteve të ndërtimit prodhohen brenda vendit.

Një gjë e tillë luan rol shumë të rëndësishëm në zëvendësimin e importeve dhe hapjen e vendeve të reja të punës. Në përgjithësi, shumica e produkteve të prodhuara në këtë sektor i përkasin industrisë së metalurgjisë dhe procesimit të metaleve.

Sa i përket balancit tregtar në këto produkte, për momentin ka më shumë importe se eksporte, ku shumica e importeve përbëhet nga cimentoja dhe produktet e tij. Partnerët kryesorë të Kosovës në këtë aspekt mbesin vendet e CEFTA, përcjellur nga shtetet anëtare të BE. Duke pasur parasysh burimet natyrore që Kosova ka, ky sektor paraqet mundësi për rritje të mëtutjeshme qoftë në aspekt të mbulimit të tregut vendor, apo edhe në aspekt të eksporteve.

Përpunimi i drurit

Duke pasur parasysh se 44.7% e territorit të Kosovës përbëhet nga pyjet, përpunimi i drurit llogaritet si një nga sektorët me potencialin më të madh të rritjes. Sipas një raporti të UNDP mbi tregjet në rritje në Kosovë, përpunimi i druri potencohet si një nga sektorët më të qendrueshëm në aspekt të profitabilitetit, rezultateve, punësimit dhe eksportit.

Shumica e eksporteve në këtë sektor janë për tregun e përbashkët të Bashkimit Evropian, përcjellur nga shtetet e CEFTA. Edhe pse eksportet janë rritur në periudhën 2011-2013 dhe në vitet vijuese, deficiti tregtar është rritur gjithashtu. Sa i përket strukturës së produkteve, shumica përbëhet nga mobilje të drurit

Shtojca 1 – Legjislacioni

- Ligji mbi Tregtinë e Brendshme
- Ligji mbi Tregtinë e Jashtme
- Ligji mbi Produktet e Liruara nga Detyrimet Doganore dhe me tarifë zero
- Ligji për Masat Anti-damping dhe Masat Kundërbalancuese
- Ligji mbi Masat Mbrojtëse në Importe
- Kodi Doganor dhe i Akcizave i Kosovës
- Ligji on mbi Tatimin mbi Vlerën e Shtuar
- Ligji mbi Normën e Akcizës në Kosovë
- Ligji mbi Tregtinë me Mallra Strategjike

Lista e Shkurtesave

BE – Bashkimi Evropian

BPB – Bruto Produkti i Brendshëm

CEFTA – Marrëveshja për Tregti të Lirë me Evropën Qendrore

GSP – Sistemi i Përgjithshëm Preferencial

MSA – Marrëveshja për Stabilizim Asociim

MTI – Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

MTL – Marrëveshja për Tregti të Lirë

OEAK – Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë

PMNE – Procedurat me Ndikim Ekonomik

Referencat

“Mattoo, Aaditya; Wang, Zhi; Wei, Shang-Jin. 2013. *Trade in Value Added : Developing New Measures of Cross-Border Trade*. London: Centre for Economic Policy Research and the World Bank. © World Bank. <https://openknowledge.worldbank.org/handle/10986/15809> License: CC BY-NC-ND 3.0 IGO.”

Expanding Kosovo's exports through the Generalized System of Preferences Program, Office of the U.S. Trade Representative, March 2013

Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Prishtinë: n.p., 2008. Web.

Mehmedi, Mentor, Rron Dalladaku, and Tribun Ferizaj. "Analizë e tri Politikave Prioritare mbi Zhvillimin e Tregtisë dhe Burimeve Njerëzore." (n.d.): n. pag. *Ministria e Tregtisë dhe Industrisë*. Web.

Politika Tregtare e Kosovës. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë. Web. 2009

Statistikat e Tregtisë së Jashtme. *Agjencia e Statistikave të Kosovës*. Web.

Tregtia në Kosovë - Ministria e Tregtisë dhe Industrisë. *Ministria e Tregtisë dhe Industrisë*. N.p., n.d. Web. 25 Feb. 2016.